



Planuar / Doretuar Punjenol/Prodato Received/Delivered	31.12.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMS#CK	6478/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.944/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.944/2021 të datës 18.11.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi fshati Gadime e Epërm Rr."Egzodi 99", Nr.18 ,Lipjan, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "*kërkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.944/2021 e datës 18.11.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas Akt Emërimit të datës 07.06.2019 në pozitën e punës "*Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit*", me datë 18.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për nivelizimin e koeficientit të pagës nga 8.5 në koeficientin e pagës 9 dhe atë në mënyrë retroaktive nga momenti i përzgjedhjes në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.11.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datë 02.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5524/2021 e datës 18.11.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e DMZP/MPB për Shërbimin Korrektues të Kosovës të datës 12.11.2021; E-mail nga I.LI për A.D. i datës 12.11.2021; Kërkesën e ankuesit për harmonizimin e koeficientit të pagës të datës 21.05.2021 drejtuar DMZP/MPB; Aprovimin i titujve të punës dhe koeficientit të pagës-Shërbimi Korrektues i Kosovës-MD të datës 06.02.2019; Akt Emërimit të datës 07.06.2019; Kërkesë për Aprovim të Koeficientit për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe zbatim të Legjislacionit në Drejtoratin Ligjor/SHKK i datës 04.02.2019; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 01.02.2019; Kërkesën për aprovimin e buxhetit Shërbimi Korrektues i Kosovës të datës 31.01.2019; E-mail nga A.H. për N.K. i datës 01.02.2019; E-mail nga N.K. për R.H. i datës 01.02.2019; Koeficientet Shërbimi Korrektues i Kosovës; Aktgjykimin A.nr.1476/2018 të datës 11.11.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigjen në ankesë të datës 02.12.2021; Konkursin e Brendshëm Avancim për tri pozita të nivelit të njëjtë sipas konkursit me nr. të referencës PR/010/JP00038601, Njoftimin e datës 06.05.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht sipas Akt Emërimit të datës 07.06.2019 është konstatuar se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit. I njëjti me datë 21.05.2021 ka parashtruar kërkesë pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme për nivelizimin e koeficientit të pagës nga 8.5 në 9, ndërsa ky i fundit përmes emalit zyrtar të datës 12.11.2021, ka njoftuar ankuesin se: *"nuk ka kompetencë të rregulloj shkeljet eventuale që ndodhin në kuadër të SHCK-së , ashtu siç e potenconi ju faktin e laramanisë së koeficienteve të pagave për zyrtarët e juaj"*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil pretendon se udhëheqësit e sektorëve në përgjithësi në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës kanë koeficient 9 të pagës, ndërsa vetëm pozita Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit ka koeficient 8.5 të pagës, kështu që organi i punësimit me mos nivelizimin e koeficientit të pagës nga 8.5 në 9, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore trajtim jo të barabartë dhe diskriminim lidhur me koeficientin e pagës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ju referuar dispozitave të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *1.E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës, dhe rrjedhimisht*

konstatohet se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhëniet e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Në kuptim të kësaj bazë ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi në pozitën e punës se Udhëheqësit të Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit realizon pagën në vlerën e përcaktuar me Akt Emërimit të datës 07.06.2019.

Po ashtu, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se Departamenti i Shërbimit Civil/DASHC-ja, përmes shkresës me numër protokollit 333 të datës 06.02.2019, ka miratuar titullin e punës "Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit" dhe njëkohësisht për pozitën në fjalë ka njohur koeficientin 8.5 të pagës. Pas këtij miratimi, Shërbimi Korrektues i Kosovës me datë 10.04.2019 ka shpallur Konkursin e brendshëm me numër referencë LI/09/JP00038625, për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit, me koeficient 8.5 të pagës, e në të cilin konkurs ka aplikuar ankuesi, ku i njëjti bazuar në njoftimin e datës 06.05.2019 është përzgjedhur në pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit dhe ka nënshkruar Akt Emërimit të datës 07.06.2019 me koeficient 8.5 të pagës. Andaj, bazuar në konstatimet si me lartë, dhe meqenëse Kolegji në provat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë akt administrativ të organit të punësimit përmes të cilit ankuesit i është njohur harmonizimi i koeficientit të pagës nga 8.5 në 9, kështu që Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për nivelizimin e koeficientit si dhe kompensimin e diferencës së pagës në mënyrë retroaktive nga data e përzgjedhjes së tij është i pa bazuar.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 944/2021

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;